



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 2126/9 Prot.

Tiranë, më 16.09 2025

VENDIM
Nr. 101 datë 16.09 2025

PËR
NËNSHKRIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT
NDËRMJET UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS
DHE UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË TIRANËS

Mbështetur në nenin 3, pika 4, gërma “c” dhe nenin 38 të Ligjit nr. 80/2015 ‘Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë’, në nenin 20, pika “s” të Statutit të Universitetit të Sporteve të Tiranës si dhe në Vendimin e Rektoratit nr. 100 datë 11/09/2025, Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 16/09/2025,

V E N D O S I:

1. Miratimin e marrëveshjes të bashkëpunimit ndërmjet **Universitetit të Sporteve të Tiranës** dhe **Universitetit Politeknik të Tiranës**.
2. Ky Vendim i përcillet Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore për publikim në faqen zyrtare të institucionit.
3. Ngarkohet për zbatimin dhe ndjekjen e të gjitha procedurave të nënshkrimit Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë, Publikun dhe Studentët.
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I SENATIT

Prof.Dr. AGRON KASA





**UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
TIRANËS**

Nr. _____ Prot, datë ____, ____, 2025



UNIVERSITETI I SPORTEVE TË

Nr. _____ Prot, datë ____, ____, 2025

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË TIRANËS

DHE

UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS

Universiteti Politeknik i Tiranës i përfaqësuar nga Prof. Dr. Akli FUNDO dhe Universiteti i Sporteve të Tiranës i përfaqësuar nga Prof. Dr. Agron KASA, në zbatim të kompetencave të tyre përkatëse, bien dakord të bashkëpunojnë për nxitjen e shkëmbimit të shumanshëm në funksion të zhvillimit institucional.

Neni 1

Fushat e bashkëpunimit

Marrëveshja synon të vendosë dhe të thellojë bashkëpunimin midis Universitetit Politeknik të Tiranës dhe Universitetit të Sporteve të Tiranës, në fushat dhe drejtimet e mëposhtme:

- Shkëmbimin e personelit akademik për dhënie leksionesh të veçanta në lëndët, apo modulet që ata i gjykojnë me interes, sipas kushteve dhe mundësive;
- Shkëmbimin e studentëve, sipas kushteve dhe mundësive;
- Shkëmbimin e botimeve akademike, apo periodike;
- Ndihmën reciproke në kualifikimet e personelit akademik, nëpërmjet organizimit të seminareve trajnuese, apo udhëheqjes shkencore për përgatitje dhe mbrojtje mikrotezash;
- Pjesëmarrjen e personelit akademik në veprimtari të përbashkëta studimore;
- Pjesëmarrjen e personelit akademik në projekte të përbashkëta kërkimore dhe shkencore;
- Informimin reciprok për organizimin e konferencave shkencore nga ana palëve, ose në bashkëpunim me fakultete apo institucione homologe, vendase ose te huaja, si dhe inkurajimin e pjesëmarrjes së personelit akademik në këto veprimtari;
- Krijimin e mundësive dhe hapësirave për botime shkencore në revistat e insitucioneve nga personeli akademik;

Neni 6

Dispozita të fundit

- Marrëveshja përgatitet dhe nënshkruhet në 2 (dy) kopje me të njëjtën vlerë juridike.
- Palët angazhohen se janë të gatshme të bashkëpunojnë për realizimin dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.
- Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi u nënshkrua sot, me datë ____/____/2025 dhe hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të saj.

Universiteti Politeknik i Tiranës

REKTORI

Prof. Dr. Akli FUNDO

Universiteti i Sporteve të Tiranës

REKTORI

Prof. Dr. Agron KASA
